

VENDIM
Nr. 869, datë 14.12.2016

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 246, DATË 19.3.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR NGARKIMIN E GARDËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
KRYERJEN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT PËR MARRJEN ME QIRA
FINANCIARE TË AUTOMJETEVE NË DISPOZICION TË DISA FUNKSIONARËVE
PUBLIKË DHE KRYEMINISTRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 246, datë 19.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për ngarkimin e Gardës së Republikës së Shqipërisë për kryerjen e procedurës së prokurimit për marrjen me qira financiare të automjeteve në dispozicion të disa funksionarëve publikë dhe Kryeministrisë”.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama